

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me sekretaren juridike Ardrita Imeri, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], nga Ferizaj, rruga "[REDAKTUAR]", i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1014-4/2017 të dt 28.10.2017, për shkak të veprës penale deklarimet e rreme nga neni 392 par 1. të KPRK-së, ka vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.19.12.2017 solli:

AKT GJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1014-4/2016 të dt 20.10.2017, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga "[REDAKTUAR]", I lindur më [REDAKTUAR], në fshatin [REDAKTUAR], Komuna Shtërpçë, nga i ati [REDAKTUAR] e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR] mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

- se me dt. 12.05.2016 rreth orës 16:00, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka deklaruar rrejshëm lidhur me rastin i cili kishte ndodhur gjatë vitit 2011, i njëjti kishte ndryshuar deklaratën dhe kishte rënë në kundërshtim me atë që kishte deklaruar më herët në polici,-

- për shkak të veprës penale deklarimet e rreme nga neni 392 par 1. të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqiptoi dënimin në shumën prej 100 (njëqind) Euro, të cilën shumë e akuzuara, obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1014-4/2016 të dt 20.10.2017, ka akuzuar [REDAKTUAR], nga Ferizaj, rruga "[REDAKTUAR]" për shkak të veprës penale deklarimet e rreme nga neni 392 par 1. të KPRK-së, dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të pandehurit të i shqiptoj dënim me gjobë me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 parag.1, 2 dhe 3 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 12.05.2016, deklaratat e dëshmitarit [REDAKTUAR] dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 26.05.2016, procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i përpiluar në Gjykatën Themelore në Ferizaj në lëndën P.nr.662/14 i dt.12.05.2016 në të cilën ka deklaruar rrejshëm i pandehuri i cila gjendet në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale deklarimet e rreme nga neni 392 par 1. të KPRK-së.


Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 dhe 451 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.2631/17 i dt.19.12.2017

Sekretarja juridike
Ardrita Imeri

Gjyqtari
Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.